



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:048209

Datë: 04.02.2019

Numri i dokumentit: 00218060

P. nr.593/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. (P). O. nga Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik neni 378 par. 6-1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore-Departamenti Përgjithshëm në Gjakovë, PP/II.nr.1018/2018 të dt.29.08.2018, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, **me 04.10.2018**, murr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë PP/II.nr.1018/2018 të dt.29.08.2018 dhe kjo gjykatë, jep këtë :

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

A. O. i biri i P. dhe e i nënës M., e lindur H., data e lindjes ..., në Gjakovë, ku edhe tani banon, në rr. “...” – Dardani, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

-Më dt.15.07.2018 rreth orës 16:30 min, në Gjakovë, në rrugën “...” në transit në drejtim të Hallës së Sportit, pikërisht tek semaforët, rrezikon trafikun publik duke shkelur numrin 68 lidhur me nenin 255 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, nr.05/L-088 dhe vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se me një veprim të tillë do të vijë deri te pasojat e ndaluara, lehtas ka marrë se gjer te ajo nuk do të vjen apo në momentin e duhur do ti shmanget dhe pasoja është shkaktuar në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës “...” me targa Zvicerane të regjistrimit ..., ngjyrë e bardhë me të arritur tek vendi kritik, duke mos mbajtur distancën e nevojshme të sigurisë me automjetin para tij si pasojë me pjesën e përparme të krahut të majtë e godet në

pjesën e përparme të krahut të djathtë dhe e qet jashtë rrugës automjetin e markës "... .." me targa të regjistrimit ..., ngjyrë hiri të cilin e drejtonte M. K. me ç' rast përpos dëmeve materiale në automjete, lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari M. K. lëndime të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore, të Dr. V. K. të datës 09.08.2018.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut nga neni 378 par. 6-1 të KPRK-së.

Andaj ,Gjykata konform nenit 4,41,43, 46,73, dhe nenit 378/6-1 te KPRK-së ,si dhe nenit 495 te KPPK-se ,të akuzuarin A. O. e :

G J Y K O N

A. O. i cakton dënimin me gjobë në shumë prej **200,00 € (dyqind) euro**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë, së këtij Aktgjykimi -Urdhër ndëshkimor, në kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 49 par.4 të KPPK-së , do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20 € (njëzet euro)**.

I dëmtuari M. K. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej **71.10 €** (në emër të ekspertizës së komunikacionit dhe në emër të ekspertizës mjeko-ligjore) si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00 €** , në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të marr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP/II.nr.1018/2018 të dt.29.08.2018, ndaj të akuzuarit A. O. nga Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 parag. 6-1 të KPRK-së.

Komfor nenit 493 te KPPK-së , PTH në Gjakovë , kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit ti shqiptoj dënim me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës së nenit 378/6-1 te KPRK-së e cila dispozitë për kryesit e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose dënim me burgim gjerë ne 3(tre) vite .

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraparak të çështjes komfor nenit 495 te KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-se dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH –se në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Kallëzimi Penal me nr. të rastit nr. ER-3004-199-2018 i dt.15.07.2018 nga Njësiti i Hetimeve pranë Stacionit Policor në Gjakovë,
- Raporti polici mbi vend shikimin e aksidentit me nr. të rastit ER-3004-199-2018,i dt.15.07.2018
- Procesverbal mbi intervistimin e të dyshuarit me nr. të rastit ER-3004-199-2018,i dt.15.07.2018
- Deklarata e të dëmtuarit M. K. dhënë në st. policor me dt.15.07.2018
- Akt Ekspertimi Mjeko Ligjor, i dt.09.08.2018,
- Ekspertiza e aksidentit të trafikut, e dt.06.08.2018,
- Foto-dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë.

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se i akuzuari është kryes të veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 te KPK-së në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr konform nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.593/18, te dt.04.10.2018

Sekretarja juridike:
Flutur Nagavci

Gjyqtarja
Iirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës ,Gjyqtares të kësaj Gjykate. Nëse e pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.